

KËRKESË
Nr. 2987, datë 22.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, për pasuritë e llojit “arë””.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikun, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “arë”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 26 588 800 (njëzet e gjashtë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIME

SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga projekti “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”

Nr.	Pronari			zona kad	Nr. pas	Lloji pas	Sip. Totale (m2)	Vlerësimet			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					Sip Shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	
1	BP. Hatixhe Balla, Ibrahim Balla, Islam Balla, Metie Balla, Sulejman Balla, Zenepe Balla,			3866	193/29	Arë	11000	11000	448	4928000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Asllan	Sule	Shima	3866	123/11/1	Arë	6250	6250	448	2800000	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Hysen	Ymer	Basha	3866	193/1	Arë	3200	2470	448	1106560	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Hamit	Bajram	Koçi	3866	193/27	Arë	4630	4630	448	2074240	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Bashkim	Liman	Hoxha	3866	202/2	Arë	5000	4300	448	1926400	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Ali	Jaho	Shehu	3866	181/16	Arë	3600	3000	448	1344000	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Gëzim	Hyqmet	Shehu	3866	181/15	Arë	3600	2300	448	1030400	Konfirmuar nga ZVRPP
8	BP Genci Arif Koçi, Zamir Arif Koçi			3866	193/26	Arë	10000	10000	448	4480000	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Ramazan	Xhemal	Hoxha	3866	202/2/1	Arë	5000	4400	448	1971200	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Lavdërim		Tota	3866	181/27	Arë	3700	3000	448	1344000	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Kadri	Osman	Hasmuça	3866	181/20	Arë	4800	4800	448	2150400	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Haxhi	Sabri	Hasmuça	3866	181/19	Arë	3200	3200	448	1433600	Konfirmuar nga ZVRPP
Shuma								59350		26588800	

